



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER ARDJANA A. MEDIU
ADRESA Blv.Deshmoret e Kombit,
Kullat Binjake, Kulla Nr.2, Kati i 7
TEL: 692041001

KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA)

Nr. repertori: 218

Nr. koleksioni: 70

Tirane më 14/01/2022

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"

*Akti noterial përbëhet nga 6 fletë



A2022050620007756615



A2022050620007756615

**KONTRATË SHITBLERJE TË KUOTAVE TË KAPITALIT
THEMELTAR TË SHOQËRISË "Alpet Energy" sh.p.k**

Sot, më datë 14/01/2022 (dy mijë e njëzet e dy), para meje Notere Ardjana A. Mediu, Anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore Tiranë, me zyrë në adresën Tiranë, Blv."Dëshmorët e Kombit", Kullat Binjake, Kulla Nr.2, Kati i 7, u paraqitën personalisht:

SHITËSI

Z.Ingrit Staro, atësia Nedai, amësia Luljeta, shtetas shqiptar, lindur në Bilisht, Devoll dhe banues në Tiranë, me adresë: Rr. "Panajot Pano" Nd. 11; H. 3; Kashar; Yzberish; 1050; Tiranë, lindur më 21/04/1990, gjendja civile i martuar, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar prej meje me Letërnjoftim ID Nr. 035636345 dhe Nr.Personal J00421034S.

Dhënëse Pëlqimi: Zj.Paola Staro, atësia Eduart, amësia Aida, shtetase shqiptare, lindur në Fier dhe banuese në Tiranë, me adresë: Rr "Panajot Pano" Nd. 11; H.3; Kashar; Yzberisht; 1050; Tiranë, lindur më 15/11/1993, gjendja civile e martuar, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar prej meje me Letërnjoftim ID Nr. 037017842 dhe Nr. Personal J36115100Q.

BLERËSI

Z.Vladimir Mulaj, atësia Adulla, amësia Drita, shtetas shqiptar, lindur në Tropojë dhe banues në Tiranë, me adresë: Rr."Vellezerit Kondi" Njësia Administrative Nr. 2; Njesia Bashkiake Nr. 2; 1003; Tiranë, lindur më 20/09/1967, gjendja civile i martuar, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar prej meje me Letërnjoftim ID Nr. 036456480 dhe Nr. Personal G70920225W.

Për identitetin e të cilëve u sigurova në bazë të letërnjoftimeve të tyre elektronike si dhe referuar dispozitave ligjore të Kodit Civil të Republikë së Shqipërisë konkretisht Neneve: 79,80,659,690 dispozitave të Ligjit Nr. 9901/2008 " Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe Vendimit datë 11.01.2022 të Shoqërisë "Alpet Energy"sh.p.k palët e sipërcituara disponojnë lirisht me vullnet të plotë këtë kontratë të shitjes së kuotave të shoqërisë me kushtet dhe afatet si më poshtë vijon:

NENI 1

KUSHTET E KONTRATËS

Në lidhjen e kësaj Kontrate ekziston pëlqimi i palëve në marrjen përsipër të detyrimeve përkatëse, shkaku i ligjshëm në të cilin mbështeten detyrimet, dhe objekti që formon lëndën e kontratës.

Kontrata quhet e vlefshme meqënëse palët kanë shfaqur dhe shprehur në mënyrë të ndërsjelltë vullnetin e tyre, duke u marrë vesh për të gjitha kushtet thelbësore të saj.



Në këtë Kontratë, palët shprehin dhe garantojnë që shkak i ligjor i lidhjes së saj nuk është i paligjshëm, nuk vjen në kundërshtim me ligjin, rendin publik si dhe Kontrata nuk shërben si mjet për të shmangur zbatimin e një norme të legjislacionit shqiptar.

Ekzistojnë këto kushte paraprake

Rezulton se Shoqëria "Alpet Energy" Sh.p.k, është person juridik shqiptar regjistruar pranë QKB datë 10.06.2019 me NUIS L99210601A, me kapital themeltar prej 100,00 dhe numër të përgjithshëm kuotash 1,00.

Shoqëria ka si objekt veprimtarie "prodhim energjie elektrike, ndertimi i hidrocentraleve, termocentraleve apo impianteve. Shitja dhe blerja e energjise elektrike nga operatorë të ndryshem. Transmetimi i energjisë elektrike ne sistemin e tensionit të lartë, funksion i cili përfshin transmetimin ose interkonjeksionin ndërkombëtar. Përdorimin e sistemeve të linjave, strukturave mbështetëse dhe pajisjesh, transformuese dhe kontrolluese për transmetimin e energjisë elektrike dhe të dispencimit. Shpërndarjen, transportin e energjisë elektrike në sistemet shpërndarëse të tensionit, të mesëm dhe të ulët, duke patur parasysh shpërndarjen deri tek konsumatori i fundit.

Ortak i shoqërisë është:

1. **Z.Ingrit Staro**, ortak i vetëm i cili zotëron 100% të kapitalit të shoqërisë me vlerë 100.00.

Në datë 11.01.2022 Ortaku i Vetëm i Shoqërisë "Alpet Energy" Sh.p.k, Z.Ingrit Staro, ka vendosur shitjen e kuotave të kapitalit themeltar që përfaqëson në shoqëri.

NENI 2 QËLLIMI I KONTRATËS

Qëllimi i kësaj Kontrate është transferimi i pronësisë kundrejt pagesës, të Kuotave të Kapitalit Themeltar të Shoqërisë Tregtare "Alpet Energy" Sh.p.k që zotëron Shitësi, në favor të Blerësit.

Kjo Kontratë shërben për përcaktimin e kriterëve, procedurave dhe mënyrave të transferimit të kësaj pronësie, si dhe pagesat përkatëse në lidhje me këtë transferim.

Me anë të këtij veprimi juridik të dyanshëm, palët synojnë të krijojnë një marrëdhënie juridike ndërmjet tyre, e cila mbështetet në parimet e ndërshtetësisë, ligjshmërisë dhe besimit reciprok ndërmjet palëve.

Në përcaktimin e kushteve, Palët në kontratë përcaktojnë lirisht përmbajtjen e saj, dhe angazhohen të kryejnë veprimet e tyre brenda kufijve të vendosura nga legjislacioni në fuqi dhe nga përmbajtja e kësaj kontrate.

NENI 3 OBJEKTI I KONTRATËS

Objekti i kësaj Kontrate është transferimi nëpërmjet shitjes i kuotës prej 100% që Z. Ingrit Staro, zotëron në kapitalin themeltar në shoqërisë "Alpet Energy" Sh.p.k tek Blerësi Z.Vladimir Mulaj.

Shitësi ka të drejtë të plotë dhe ekskluzive të pronësisë dhe posedimit të kuotave të kapitalit të shoqërisë tregtare "Alpet Energy" Sh.p.k.

Shitësi transferon 100% kuotën që zotëron në kapitalin themeltar në Shoqërinë "Alpet Energy" Sh.p.k, sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij neni, duke dorëzuar pronësinë dhe posedimin e kapitalit të Shoqërisë "Alpet Energy" Sh.p.k me të gjitha të drejtat që rrjedhin prej tyre Blerësit Z.Vladimir Mulaj.



NENI 4 CMIMI I SHITJES SË KAPITALIT DHE MËNYRA E PAGESËS

Vlera e kapitalit themeltar në masën është vlerësuar nga palët si më poshtë vijon:

- 100% e kapitalit themeltar të shoqërisë me zotërues **Z.Ingrit Staro** i shiten Blerësit **Z.Vladimir Mulaj** në vlerën prej **100.000 (njëqind mijë) Lekë**.

Çmimi i shitjes do të likuidohet në llogarinë bankare të shitësit me të dhënat si më poshtë vijon:

1. Ingrit Staro

Nr. Llogarisë:AL4621511031ALL1000010684000

Banka : FIBANK SH.A

NENI 5 MËNYRA E KALIMIT TË PRONËSISE SË KAPITALIT

Me nënshkrimin e kësaj kontrate Shitësi:

Z.Ingrit Staro, humbet plotësisht të drejtën e pronësisë mbi Shoqërinë "Alpet Energy"Sh.p.k duke njohur plotësisht me të gjitha të drejtat dhe detyrimet Z.Vladimir Mulaj.

NENI 6 TË DREJTAT DHE DETYRIMET E SHITËSIT

Shitësi merr përsipër të njoftoj, garantoj dhe siguroj Blerësin se deri në momentin e lidhjes dhe nënshkrimit të Kontratës këto kuota:

- Nuk janë objekt i ndonjë konflikti gjyqësorë.
- Nuk janë të bllokuara për llogari të të tretëve, se kuotat objekt shitje janë plotësisht të lira nga çdo barrë, detyrim , të drejta reale apo çdo lloj kufizimi tjetër.
- Shitësi është pronar ligjorë dhe nuk kanë persona të tjerë që mund të kenë pretendime në lidhje me këto kuota.
- Dokumentacioni i bashkalidhur kësaj kontrate janë origjinale, ligjore dhe nuk janë marrë në rrugë të kundraligjshme.
- Nuk kanë asnjë kontratë të lidhur më përpara e cila të ketë ndikim drejtëpërdrejtë mbi pronësinë mbi këto kuota.
- Shitësi nuk ka detyrime të paguara në favor të të tretëve dhe se shoqëria nuk ka detyrime financiare të pashlyera apo aq më tepër të padeklaruara ndaj të tretëve, përveç atyre të deklaruara në pasqyrat financiare të shoqërisë që i janë bërë të ditura palës blerëse përpara nënshkrimit të kësaj kontrate;

Shitësi është i detyruar të paguaj detyrimet në shoqëri dhe ndaj shtetit deri në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate shitjeje kuotash. Pas këtij momenti detyrimet e tjera mbulohen nga Blerësi.

NENI 7 TË DREJTAT DHE DETYRIMET E BLERËSIT



A2022050620007736615

Që nga momenti i nënshkrimit të kësaj Kontrate, Blerësi do paguaj çdo lloj takse mbi kapitalet që ai zotëron në shoqëri, detyrimet ndaj të tretëve, shtetit etj.

Blerësi ka të drejtë të sillet si pronar i ligjshëm mbi këto kuota nga momenti i nënshkrimit të kësaj kontrate. Kjo kontratë është e detyrueshme edhe për trashëgimtarët, pasardhësit në detyrë të palëve.

NENI 8 PËRBËRJA E SHOQËRISË

Pas nënshkrimit të kësaj kontrate dhe regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit struktura e kapitalit të shoqërisë "Alpet Energy" Sh.p.k, do të jetë sipas tabelës si më poshtë vijon:

ORTAKËT	% NË KAPITALIN E SHOQËRISË
Z. Vladimir Mulaj	100 %

Në të njëjtat raporte me përqindjet e kuotave që zotëron në shoqëri Ortaku merr përsipër edhe detyrimet sikundër gëzon edhe të drejtat sipas Ligjit Nr. 9901/2008 " Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare.

NENI 9 EFEKTET E KONTRATËS

Kjo kontratë hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit të kontratës.

Kjo kontratë ka forcën e ligjit për palët kontraktuese.

Kontrata ka efekt ndaj të tretëve dhe subjekteve të tjera sipas parashikimeve të ligjit.

NENI 10 ZGJIDHJA E KONTRATËS

Në rastet kur njëra nga palët kontraktuese nuk përmbush detyrimet e veta të parashikuara nga kjo Kontratë, pala tjetër kontraktuese, sipas rastit, mund të kërkojë zgjidhjen e kontratës.

NENI 11 INTERPRETIMI I KONTRATËS

Në rast se do të lindë e nevojshme të interpretohet kjo Kontratë, atëherë do të sqarohet se cili ka qënë qëllimi i vërtetë dhe i përbashkët i palëve, pa u ndalur në kuptimin letrar të fjalëve, si dhe duke vlerësuar sjelljen e tyre në tërësi, para dhe pas përfundimit të kontratës.

Kushtet e Kontratës do të interpretohen njëri nëpërmjet tjetrit, duke i dhënë secilit kuptimin që del nga tërësia e aktit të Kontratës. Kontrata duhet të interpretohet në mirëbesim nga palët.

NENI 12 ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Blerësi dhe Shitësi angazhohen të bëjnë çdo përpjekje të zgjidhin mosmarrveshjet ose konfliktet e ndodhura midis tyre ose në lidhje me këtë marrëveshje me negociata direkte.



A2022050620007756615

Nëse palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrveshjes ose konfliktit ndërmjet tyre, problemet do të mundohen të vlerësohen me anë të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve sipas kontratës dhe procedurave juridike në fuqi sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.

Në rast të konflikteve gjyqësore, Gjykata kompetente do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

NENI 13 TË NDRYSHME

Ngarkohen palët ose persona të autorizuar prej tyre që të kryejë rregjistrimin e kësaj kontrate në QKB me efekt të ligjshëm nga data e kontratës.

Palët deklarojnë që janë dakort me përmbajtjen e bërë në këtë kontratë dhe se ortakëria e shoqërisë tregtare në vijim do të jetë sipas nenit 8 të kësaj kontrate.

Kontrata redaktohet në 8 ekzemplarë autentik në gjuhën shqipe me të njëjtën vlerë juridike. Secila palë mban nga një ekzemplarë, ndërsa një ekzemplarë depozitohet në QKB sipas ligjit.

Palët deklarojnë se nuk kanë asnjë pretendim për sa më sipër dhe se kanë disponuar me vullnet të lirë, të plotë dhe të pavesuar.

Pavlefshmëria e pjesëve të vecanta të kësaj kontrate nuk e çënojnë në thelb qëllimin e saj për transferim të kuotave respektive sipas nenit 3 të kësaj kontrate nga shitësit tek pala blerëse.

Kontratës i bashkangjiten kopje të letërnjoftimeve të palëve shitëse dhe blerëse dhe kopje e ekstraktit të Shoqërisë. Përfundimisht palët kontraktore, pasi redaktuan bashkarisht këtë kontratë sipas vullnetit të lirë dhe të plotë e lexojnë bashkarisht kontratën dhe pasi e gjejnë në përputhje me qëllimin e tyre si dhe vullnetin e lirë kontraktor, e nënshkruajnë personalisht duke i dhënë fuqi ligjore.

PALËT KONTRAKTORE

PALA SHITËSE
Z. Ingrid Staro

Dhënëse Pëlqimi:
Zj. Paola Staro

Paola Staro

PALA BLERËSE
Z. Vladimir Mulaj

NOTERE
Ardjana.A.Mediu

SHOQËRIA "ALPET ENERGY" SH.P.K.

Me seli në Tiranë, Njesia Bashkiake Nr 2 Rruga Kadri Kërciku

VENDIM NR3

i ASAMBLESE SE PERGJITHSHME

Sot ne Tiranë, më datë 11/01/2022, në selinë e shoqërise "Alpet Energy" sh.p.k me nipt L99210601A me administrator Znj.Ariola Hasani dhe ortak të vetëm Z. Ingrid Staro, atesia Nedai, amësia Luljeta, lindur më 21.04.1990 lindur në Bilisht, Devoll dhe banues në Tiranë, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar nepermjet Leternjoftim ID me Nr. Personal J00421034S.

Ortak i Vetëm: Z. Ingrid Staro

U mor në shqyrtim çështja e ditës si me poshtë:

Rendi i dities:

1- Transferimi i kuotave te kapitalit nëpërmjet shitjes së shoqërise ALPET ENERGY SH.P.K.

Për këto arsye pasi u përpilua proces-verbali i kësaj mbledhje:

U vendos.

- 1- Të transferojë kuotat e kapitalit të shoqërise Alpet Energy shpk në masën 1 kuote qe përbejnë 100% te kapitalit të shoqërise Alpet Energy shpk. Me vlerë 100,000 lekë që i përkasin ortakut të vetëm Z. Ingrid Staro do të transferohen në dobi te Z. Vladimir Mulaj duke përfituar:
 - Z. Vladimir Mulaj 100% të kapitalit të shoqërise Alpet Energy Shpk


Pas regjistrimit të vendimit dhe kontratës së shitjes të kuotave, ortak i vetëm do të jetë Z. Vladimir Mulaj i cili do të zotërojë 100% të vlerës së kapitalit të shoqërisë që përfaqëson 1 kuotë.

Ky vendim merret nga ortakut i vetëm në përputhje me statutin e shoqërisë dhe me Ligjin "Për shoqëritë Tregtare".

Për "Alpet Energy" sh.p.k.

Ortakut i vetëm

Z. Ingrid Staro





REZULTATET E KËRKIMIT

Numri i Rezultatit të Kerkimit:	D-202201148491193
Data e Rezultatit të Kerkimit:	14.01.2022
Ora e Rezultatit të Kerkimit:	8:49:01AM
Lloji i Kerkimit:	
Numri i Dokumentit:	D-400-005-738
Referenca e Perdoruesit:	

LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KERKIMI 0

INGRIT NEDAI STARO
ALPET ENERGY SH.P.K.



[Handwritten signature]

